




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 50 datë 25.08.2020

“Për rishikimin e Kontratës së Shërbimit “Për depozitimin administrimin menaxhimin e mbetjeve urbane”; dhe miratimin e zonave për krijimin e landfillit të ri për mbetjet urbane dhe mbetjet teknologjike dhe parashikimin e këtij shërbimi në kontratë.”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 te ligjit nr. 8417, date 10. 1998 “Kushtetuta Republikës së Shqipërisë”, (të ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.2, shkronja “a” dhe “b”, pika 1.6 nenit 55te ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore, me propozim të Shoqërisë “Ndërkomunale Bushat Sh.a”,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin sipas draftit bashkëlidhur këtij vendimi të rishikimit të Kontratës së shërbimit “Per depozitimin, Administrimin, përpunimin dhe riciklimin e Mbetjeve urbane në vend - depozitimin (Lendfill) Bushat, Vau Dejës” me palë; Shoqëria Ndërkomunale Bushat sh.a, me seli ne Bushat Vau Dejës, regjistruar si person Juridik në QKB me datë 08.09.2008, identifikuar me NIPT K87108002A, me seli në Bushat dhe Shoqëria “Becker Albania sh.a” me seli në Njësinë Administrative Bushat, regjistruar si person Juridik ne QKB me datë 29.09.2010 identifikuar me nr. NIPT I02207017E si dhe shtimin në landfill dh të shërbimeve të grumbullimit të inerteve dhe të mbeturinave teknologjike.
2. Përcaktimin e çmimit për shërbimin e depozitimin, administrimin, përpunimin, riciklimin e mbetjeve **urbane** në vend - depozitimin (landfill) Bushat, Vau Dejës në vlerën **1500** lekë pa tvsh, kundrejt Shoqërisë Ndërkomunale Bushat. Kjo tarifë do të hyjë në fuqi nga data 01.01.2021, në mënyrë që të japi kohë operatorëve të bëjnë parashikimet e nevojshme në buxhetin e vitit 2021.
3. Kontratat me operatorët do të lidhen të gjitha nga Shoqëria Ndërkomunale Bushat sha dhe menaxhimi i mbetjeve urbane do të bëhet vetëm nga Becker Albania Sh.a (sipas kontratës) si titullare e Lejes Mjedisore te Tipit A për: Lendfilli i mbetjeve (D1).
4. Përcaktimin e saktë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve në përputhje me legjislacionin në fuqi me një marrëveshje midis Ndërkomunale Bushat dhe Shoqërisë Becker Albania, të miratuar nga këshilli bashkiak.
5. Pagimi i vlerës **1200** leke pa tvsh nga te ardhurat e Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sh.a në favor të operatorit.

6. Shoqëria ndërkomunale Bushat të nisë procedurat administrative për të menaxhuar jo vetem mbetje urbane, **por edhe mbetjeve inerte dhe ato teknologjike** deri në lidhjen e kontratave për këtë qëllim.
7. Përcaktimin e parcelës për ndërtimin e Venddepozitimit për depozitimin, administrimin, trajtimin, perpunimin, rikuperimin e Mbetjeve të Ngurta Inerte.
8. Miratimin e çmimit paraprak për shërbimin e depozitimit, administrimit dhe rikuperimin e mbetjeve **INERTE**, në venddepozitimin që do të ndërtohet, në vlerën 500 lek pa tvsh deri në kryerjen e studimit të fisibilitetit dhe projektit të plotë nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.
9. Përcaktimin e parcelës për ndërtimin e Venddepozitimit për depozitimin, administrimin trajtimin e mbetjeve teknologjike .
10. Miratimin e çmimit paraprak për shërbimin e depozitimit, administrimit dhe rikuperimin e mbetjeve teknologjike, në venddepozitimin që do të ndërtohet, në vlerën 2500 lek pa tvsh deri në kryerjen e studimit të fisibilitetit dhe projektit të plotë nga ana e Bashkisë Vau i Dejës
11. Ndryshimi i përqindjes së tarifës së akomodimit nga 15% në 20% në favor të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha për shërbimet e sipërcituara të mbetjeve inerte dhe mbetjeve teknologjike.
12. Hartimi i studimit të fisibilitetit dhe projekteve për landfillin e mbetjeve inerte dhe ato teknologjike si dhe financimi i zbatimit të projektit.
13. Të njoftohen subjektet e interesuara lidhur me efektet ligjore të këtij Vendimi.
14. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Mark BISHA

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA



Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 31.08.2020